

R E F E R A T
I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE PËR LËNDËT PROFESIONALE-ARTISTIKE NË FAKULTETIN E ARTEVE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të Konkursit të Universitetit të Tetovës për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike dhe në thirrje të bashkëpunorëve në Universitetin e Tetovës, për një mësimdhënës për lëndët profesionale artistike në fushën e aktrimit në Fakultetin e Arteve, të shpallur në të përditshmet “Koha” dhe “Nova Makedonija” të datës 15.02.2020, si dhe në web-faqen e Universitetit www.unite.edu.mk, si dhe në bazë të vendimit nr. 20-88/3 të Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës të mbledhjes së mbajtur më 30.04.2020, u soll vendimi për formim të Komisionit recensues, në përbërje:

1. Prof. Fadil Hysaj (kryetar i komisionit), regjisor dhe profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve të *Universitetit të Prishtinës*.
2. Prof. dr Metin Izeti (anëtar i komisionit), filozof, estet dhe profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve të *Universitetit të Tetovës*.
3. Prof.dr Nebi Islami (anëtar i komisionit), dramaturg dhe profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve të *Universitetit të Prishtinës*.

Anëtarët e propozuar në mënyrë unike kanë pranuar Vendimin e Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik, pastaj kanë marrë dokumentacionin e arritur dhe i janë përveshur punës me seriozitet duke shqyrtuar në mënyrë analitike materialet që kanë pasur në dispozicion. Në bazë të konstatimeve, vlerësimeve dhe konkluzioneve, ky Komision, Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, përmes tij Senatit të Universitetit të Tetovës, ia paraqet këtë:

R E F E R A T

Në Konkursin për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike dhe në thirrje të bashkëpunorëve në Universitetin e Tetovës, për **një mësimdhënës për lëndët profesionale artistike në fushën e aktrimit në Fakultetin e Arteve** në afatin e caktuar është paraqitur një kandidat, edhe atë:
Doc. mr. Kushtrim Bekteshi.

Të dhënat biografike dhe zhvillimi profesional

Kushtrim Bekteshi është i lindur në Kumanovë më 26.02.1982. Shkollën fillore e ka mbaruar në f.Llopat-Kumanovë, ndërsa shkollën e mesme në Gjimnazin “Goce Dellçev” në Kumanovë. Nga viti 2000-2002 ka studiuar në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës, në seksionin e regjisë së teatrit, në klasën e prof. Fadil Hysaj. Nga viti 2002-2006 ka studiuar në

Fakultetin e Artit Dramatik në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në seksionin e regjisë së teatrit, në klasën e prof. Slobodan Unkovski. Ka diplomuar në vitin 2008 në Fakultetin e Artit Dramatik në Shkup, në Seksionin e Regjisë së Teatrit, me shfaqjen “Vojceku” të autorit Georg Byhner.

Kandidati mr. Kushtrim Bekteshi ka magjistruar në vitin 2011 në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup në studimet filmike dhe audiovizuale – moduli i Skenarit Filmik dhe Televiziv, nën mentorimin e profesorit inordinar dr. Sashko Nasev, me skenarin e filmit artistik të metrazhit të gjatë “Kafeneja e Shejtanit (nëntitulli: Pranverë e Paharruar në Fshatin e Harruar)”.

Nga viti akademik 2007/2008 e deri në vitin akademik 2012/2013 kandidati mr. Kushtrim Bekteshi ka ligjruar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm si DEMONSTRUES në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në lëndën REGJIA E TEATRIT, ku më pastaj lidh marrëdhënie të rregullt pune dhe nga vitin akademik 2012/2013 e deri në vitin akademik 2015/2016 ligjëron në po të njëjtin fakultet në cilësinë e bashkëpunëtorit në thirrjen ASISTENT I RI.

Në vitin akademik 2012/2013 dhe në semestrin veror të vitit akademik 2014/2015 ka ligjruar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm si ASISTENT në disipinat lëndore AKTRIM dhe REGJI TEATRI në programin studimor të Artit Dramatik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës, edhe atë: në semestrin dimëror të vitit akademik 2012/2013 në disipinat lëndore Aktrim 3 dhe Regji Teatri 3-4; në semestrin veror të vitit akademik 2012/2013 në disipinat lëndore Aktrim 2-4 dhe Regji Teatri 3-4; në semestrin veror të vitit akademik 2014/2015 në disipinën lëndore Regji Teatri 4.

Në vitin 2015 me vendim të Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup (vendimi nr.0202-308/7 i datës 23.06.2015) kandidati mr.Kushtrim Bekteshi zgjidhet mësimdhënës në thirrjen mësimore-shkencore DOCENT, dhe nga viti akademik 2015/2016 e deri në vitin akademik 2019/2020 ka ligjruar në lëndën REGJIA E TEATRIT në Fakultetin e Artit Dramatik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup.

Komisioni Recensues ka përcjellur flurudhën e zhvillimit profesional dhe krijimtarinë e mr. Kushtrim Bekteshit dhe është unik në vlerësimin se kandidati është shquar si njeri ndër studentët më të mirë të klasës, që dëshmohet me notën mesatare të diplomimit 9.64, ndërsa pas diplomimit ka dëshmuar cilësi dhe vlera të larta:

1. në veprimtarinë mësimore-arsimore,
2. në veprimtarinë profesionale-artistike,
3. në veprimtarinë profesionale-aplikative, dhe
4. në veprimtarinë me interes më të gjërë.

Me qëllim që Këshilli Mësimor-Shkencor dhe Artistik i Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës si dhe instancat më të larta vendimmarrëse ta kenë një pasqyrë më të detajuar mbi veprimtarinë e përgjithshme, sukseset, çmimet dhe shpërblimet kombëtare dhe

ndërkombëtare të kandidatit mr. Kushtrim Bekteshi, Komisioni recensues e sheh të arsyeshme që ta sjellë pasqyrën e veprave autoriale si dhe vlerësimin e tyre në hapësirën kombëtare e ndërkombëtare, nga data e vendimit të zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore Docent e deri në datën e shpalljes së këtij konkursi, respektivisht nga 23 qershor 2015 deri në 15 shkurt 2020.

Më poshtë, në pjesën e SHTOJCËS së referatit, po e japim edhe pasqyrën mbi vlerësimin dhe numrin e pikëve për valorizimin e veprave me të cilat fitohen thirrjet universitare.

Komisioni Recensues është unik në vlerësimin se bazuar në veprat autoriale, kandidati mr. Kushtrim Bekteshi është zhvilluar në njërin ndër shembëlltyrat briljante të arteve skenike mbarëshqiptare duke lënë gjurmë në vëtedijen aristike të kombit.

Kandidati ka arritur shkallë të gjërë të njohurive dhe të ngritjes profesionale me që njëj përveç shqipes standarde si gjuhë amëtare, edhe gjuhën maqedonase dhe angleze në nivel të lartë profesional, andaj me veprat e tij është zhvilluar në njërin ndër krijuesit më eminent të periudhës kohore të dhjetvjeçarit të fundit.

Siç mund të shihet nga tabelat e mëposhtme në pjesën SHTOJCË të referatit, kandidati mr. Kushtrim Bekteshi nga sfera e veprimtarisë mësimore-arsimore ka tubuar 67.95 pikë, nga sfera e veprimtarisë profesionale-artistike 96 pikë, nga sfera e veprimtarisë profesionale-aplikative 84 pikë dhe nga sfera e veprimtarisë me interes më të gjërë 29 pikë. Shuma totale prej 276.95 pikësh, duke pasur parasysh veprimtarinë e ngjeshur dhe moshën e tij, përcakton vlerësimin maksimal të veprimtarisë së tij lidhur me kontributin në punën akademike në Fakultetin e Artit Dramarik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit dhe veprimtarinë artistike në fushën e teatrit dhe filmit në hapsirat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kandidati mr. Kushtrim Bekteshi ka realizuar gjithësej 24 shfaqje teatrore, vepra autoriale, prej të cilave 4 shfaqje për fëmijë. Është skenarist dhe regjisor i tre filamave artistik, ndër të cilët dy të metrazhit të shkurtër dhe një film i metrazhit të gjatë.

Është laureat i 8 çmimeve kombëtare për regjinë më të mirë dhe 6 çmimeve për shfaqjen më të mirë, ndër të cilët vlen të theksohet Çmimi “Kult” si regjisor i vitit në Shqipëri (2010) për shfaqjen “Kush ka frikë nga Virxhinia Wulf”, Çmimi vjetor i MKRS të Kosovës për shfaqjen më të mirë në fushën e teatrit për shfaqjen “Shërbëtori i dy zotërinjëve” (2016) dhe Çmimi vjetor i MKRS të Kosovës për regjinë më të mirë në fushën e teatrit për shfaqjen “Ata që ikin” (2018).

Gjithashtu është laureat i TRE çmimeve ndërkombëtare:

1. “Audience Award” (Çmimi i publikut) në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit “PRIFEST” në Prishtinë, (2019).
2. “Special Mention” në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë “TIFF” për filmin “Pranverë e paharruar në fshatin e harruar” (2019).
3. “The Vanessa Redgrave Awards” për “Best Pitch” në PRIFORUM në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Prishtinë “PRIFEST” për projektin filmik në paraproduksion “Pranverë e paharruar në fshatin e harruar” (2014).

Nga të dhënat biografike dhe veprat autoriale të theksuara më lartë, Komisioni recensues ka konstatuar se mr. Kushtrim Bekteshi është zhvilluar në krijues poliedrik, veprat e të cilit kanë lenë gjurmë në kulturën kombëtare dhe të përgjithshme.

Mr. Kushtrim Bekteshi në veprimtarinë e tij krijuese ka kultivuar dramën, komedinë dhe filmin duke u shquar me imagjinatë të bujshme dhe invencion në plasimin e ideve, kuptimeve përkatësisht shumëkuptimësisë në përcjelljen e mesazheve dhe të koncepteve origjinale mbi rrjedhat e zhvillimeve të mundshme aktuale dhe futuriste. Nga ky këndvështrim veprat e tij autoriale kanë dimensionin ideoestetik që prekë rrafshet metafizike dhe reale. Ne to gjejmë ritmet dhe shqetësimet ekzistenciale të njeriut në rrafshin filozofik, religjioz, historik dhe aktual dhe pikërisht polivalenca e ketyre veprave ndikon në vetëdijen dhe ndërgjegjen bashkëkohore të ngarkuar me ankthe dhe sfida të panumërta.

Nga informatat që ka pasur në dispozicion ky komision, ka konstatuar se kandidati është i socializuar, i hapur, komunikativ dhe i aftë për transmetimin e njohurive edukative – mësimore profesionale në nivel akademik.

Kandidati në fjalë bashkë me fletë aplikimin ka dorëzuar edhe: Vendimin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore DOCENT; Diplomën e Studimeve deridiplomike; Diplomën e Magjistraturës; Biografinë me listën e veprimtarisë profesionale-artistike; Kopje origjinale të punimit të Magjistraturës; Vërtetimin për njohjen e gjuhës angleze; Certifikatën e nënshtetësisë dhe Certifikatën nga libri amë i të lindurve.

Nga të gjitha konstatimet, vlerësimet dhe gjykimet që ka nxjerrë në bazë të veprës autoriale dhe të përvojës pedagogjike profesionale për kandidatin mr. Kushtrim Bekteshi, Komisioni recensues në unison të plotë, Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, përmes tij Senatit të Universitetit të Tetovës, ia paraqet këtë:

PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të pasqyrës të prezantuar më lartë dhe nga të dhënat më poshtë në **Shtojcë**, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, profesionale-artistike, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati mr. Kushtrim Bekteshi në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrjet mësimore-shkencore për lëndët profesionale-artistike dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, ka tubuar gjithsej **276.95 pikë** nga referencat profesionale dhe me këtë e ka kaluar numrin minimal të pikëve që duhet të realizohen për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore për lëndët profesionale artistike **PROFESOR INORDINAR**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues përfundon se mr. Kushtrim Bekteshi ka kualitet mësimor-shkencor dhe profesional dhe sipas Ligjit për arsim të lartë si dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore, thirrjet mësimore-shkencore për

lëndët profesionale-artistike dhe thirrje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të zgjidhet në thirrjen që ka konkurruar.

Mbështetur në punën paraprake mësimore-shkencore në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit dhe Universitetin e Tetovës, poashtu në thirrjen paraprake mësimore-shkencore DOCENT, si dhe në krijimtarinë artistike, veprën voluminoze dhe të vlefshme autoriale, Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor dhe Artistik të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Tetovës, Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, përmes tij Senatit të Universitetit të Tetovës që kandidati mr. Kushtrim Bektoshi të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **PROFESOR INORDINAR** në lëndën **Arti dramatik - Aktrim**, në programin studimor të Artit Dramatik në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Tetovës.

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Fadil Hysaj, kryetar

2. Prof. dr. Metin Izeti, anëtar

3. Prof. dr. Nebi Islami, anëtar

SH T O J C Ë
PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJE TË NJË MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA
THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE PËR LËNDËT PROFESIONALE-ARTISTIKE
NË FAKULTETIN E ARTEVE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Kandidati: Kushtrim Fadil Bektashi

Institucioni: Fakulteti i Arteve (Arti Dramatik) – Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lëmia shkencore: Aktrim (lëndët profesionale artistike në fushën e aktrimit)

I. VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE

(qërshor 2015 – shkurt 2020 në Fakultetin e Artit Dramatik-Shkup)

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	Nr. i orëve x Javët x pikët	
1	Regji teatri – Teknikat bazë të punës me aktorin (semestri I, 2015/16) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
2	Regji teatri – Mizanskeni në regjinë teatrore (semestri II, 2015/2016) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
3	Regji teatri – Kompozicioni i formave komplekse teatrore (semestri I, 2016/2017) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
4	Regji teatri – Stili dhe zhanri i shfaqjes teatrore (semestri II, 2016/2017) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
5	Regji teatri – Teknikat e avancuara në regjinë teatrore (semestri I, 2017/2018) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
6	Regji teatri – Puna përgaditore për shfaqjen e diplomës (semestri II, 2017/2018) ligjerata 8 x 15 x 0.04	4.8
7	Regji teatri 1 (semestri I, 2018/2019) ligjerata 5 x 15 x 0.04	3
8	Regji teatri 2 (semestri II, 2018/2019) ligjerata 5 x 15 x 0.04	3
9	Regji teatri 3 (semestri I, 2019/2020) ligjerata 5 x 15 x 0.04	3
10	Regji Teatri – Teknikat bazë të punës me aktorin (semestri I, 2015/16) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7
11	Regji teatri – Mizanskeni në regjinë teatrore (semestri II, 2015/2016) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7
12	Regji teatri – Kompozicioni i formave komplekse teatrore (semestri I, 2016/2017) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7
13	Regji teatri – Stili dhe zhanri i shfaqjes teatrore (semestri II, 2016/2017) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7
14	Regji teatri – Teknikat e avancuara në regjinë teatrore (semestri I, 2017/2018) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7

15	Regji teatri – Puna përgaditore për shfaqjen e diplomës (semestri II, 2017/2018) ushtrime 6 x 15 x 0.03	2.7
16	Regji teatri 1 (semestri I, 2018/2019) ushtrime 5 x 15 x 0.03	2.25
17	Regji teatri 2 (semestri II, 2018/2019) ushtrime 5 x 15 x 0.03	2.25
18	Regji teatri 3 (semestri I, 2019/2020) ushtrime 5 x 15 x 0.03	2.25
19	Bazat e regjisë së teatrit 1 (semestri I, 2015/2016) ligjerata 2 x 15 x 0.04	1.2
20	Bazat e regjisë së teatrit 2 (semestri II, 2015/2016) ligjerata 2 x 15 x 0.04	1.2
21	Bazat e regjisë së teatrit 1 (semestri I, 2016/2017) ligjerata 2x15x0.04	1.2
22	Bazat e regjisë së teatrit 2 (semestri II, 2016/2017) ligjerata 2 x 15 x 0.04	1.2
23	Bazat e regjisë së teatrit 1 (semestri I, 2018/2019) ligjerata 2 x 15 x 0.04	1.2
24	Bazat e regjisë së teatrit 2 (semestri II семестр, 2018/2019) ligjerata 2 x 15 x 0.04	1.2
GJITHSEJ PIKË nga veprimtaria mësimore-arsimore:		67.95

II. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – ARTISTIKE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit: Shfaqja apo prezantimi publik i veprës artistike në format të njohur për publikun – filma, shfaqje teatrore, ngjarje kulturore (2015-2020)	Pikët
1	Regjisor i shfaqjes teatrore “MANDRAGOLA” nga Makiaveli, produksion i INQK „Trajko prokopiev,, – Drama Shqipe, Kumanovë, 2019	8
2	Regjisor i shfaqjes teatrore “NJË LETËR E HUMBUR” nga Jon Luka Karaxhale, produksion i Teatrit të Tetovës, 2019.	8
3	Regjisor i filmit artistik me metrazh të gjatë “PRANVERË E PAHARRUAR NË FSHATIN E HARRUAR” – produksion i „Manufaktura Production,, (Maqedoni), në koproduksion me „Media&Film Production,, (Kosovë), „Ska-ndal Production,, (Shqipëri) dhe „Skupifest,, (Maqedoni), 2019.	10
4	Skenarist i filmit artistik me metrazh të gjatë “PRANVERË E PAHARRUAR NË FSHATIN E HARRUAR” – produksion i „Manufaktura Production,, (Maqedoni), në koproduksion me „Media&Film Production,, (Kosovë), „Ska-ndal Production,, (Shqipëri) dhe „Skupifest,, (Maqedoni), 2019.	10

5	Regjisor i shfaqjes teatrore “DUET PËR NJË” nga Tom Kempinski, produksion i Teatrit Shqiptar-Shkup, 2019.	8
6	Autor i tekstit “ATA QË IKIN” produksion i Teatrit “Bekim Fehmiu” - Prizren, 2017.	8
7	Regjisor i shfaqjes teatrore “ATA QË IKIN” nga Kushtrim Bekteshi, produksion i Teatrit “Bekim Fehmiu” - Prizren, 2017.	8
8	Regjisor i shfaqjes teatrore “TARTUFI” nga Moliere, produksion i Teatrit “Migjeni” – Shkodër, 2017.	8
9	Skenograf në shfaqjen teatrore “TARTUFI” nga Moliere, produksion i Teatrit “Migjeni” – Shkodër, 2017.	4
10	Regjisor i shfaqjes teatrore “NJERIU, KAFSHA DHE VIRTYTI” nga Luixhi Pirandelo, produksion i Teatrit “Adriana Abdullahu” - Ferizaj, 2017.	8
11	Regjisor i shfaqjes teatrore “ARSENIKU DHE DANTELAT E VJETRA” nga Xhozef Keserling, produksion i Teatrit Shqiptar - Shkup, 2016.	8
12	Regjisor i shfaqjes teatrore “SHËRBËTORI I DY ZOTËRINJVE” nga Carlo Goldoni, produksion i Teatrit “Bekim Fehmiu” - Prizren, tetor 2015.	8
GJITHSEJ PIKË nga veprimtaria profesionale – artistike:		96

III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
	Pjesmarrja e veprave të tij (shfaqjeve teatrore dhe filmave) në manifestime kombëtare dhe ndërkombëtare (2015-2020)	
	<i>Me filmin artistik me metrazh të gjatë “Pranverë e paharruar në fshatin e harruar” (skenarist dhe regjisor):</i>	
1	2019 – Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Moskë, Rusi (Moscow International Film Festival).	4
2	2019 – Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Nansi, Francë (Nancy International Film Festival).	4
3	2019 – „PRIFEST,, Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Prishtinë, Kosovë (“PRIFEST” Prishtina International Film Festival). Çmimi „Audience Award”.	4
4	2019 – Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Tiranë, Shqipëri (Tirana International Film Festival). Çmimi “Special Mention”.	4

5	2019 – “TIFF ODA” Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Tetovë, Maqedonia e Veriut (“TIFF ODA” Tetovo International Film Festival).	4
6	2020 – Festivali i Filmit Ballkanik në Cineplexx Shkup, Maqedonia e Veriut.	2
	<i>Me shfaqjen teatrale “Një letër e humbur” (regjisor):</i>	
7	2019 – Festivali i Teatrove në Ferizaj. <i>Çmimi për regjinë më të mirë.</i>	4
8	2019 – Festivali Ndërkombëtar i Teatrit në Tetovë.	4
	<i>Me shfaqjen teatrale “Duet për një” (regjisor):</i>	
9	2019 – Festivali multimedial “Etnofest Kukaj”. <i>Çmimi për regjinë më të mirë.</i>	4
	<i>Me shfaqjen teatrale “Ata që ikin” (autor i tekstit dhe regjisor):</i>	
10	2018 – Festivali Ndërkombëtar i Teatrit “Otello” në Gostivar. <i>Çmimi për regjinë më të mirë.</i>	4
11	2018 – Festivali Teatror në Ferizaj.	4
12	2018 – Festivali Mbarëkombëtar i Tetarit në Tiranë.	4
	<i>Me shfaqjen teatrale “Tartufi” (regjisor dhe skenograf):</i>	
13	2018 – Festivali Ndërkombëtar i Teatrit Ballkanik në Bursa, Turqi (Bursa International Balcan Countries Theater Festival)	4
14	2017 – Festivali i Teatrove në Ferizaj. <i>Çmimi për regjinë më të mirë.</i>	4
15	2017 – „Kokofest,, Festivali i Komedisë në Korçë.	4
16	2017 – Festivali i Komedisë në Preshevë. <i>Çmimi për shfaqjen më të mirë.</i>	4
17	2017 – „Komedia Fest,, Festivali i Komedisë në Gjakovë.	4
	<i>Me shfaqjen teatrale “Arseniku dhe dantelat e vjetra”(regjisor):</i>	
18	2016 – Festivali i Teatrove „Vojdan Çernodrinski,, në Prilep.	4
	<i>Me shfaqjen teatrale “Shërbëtori i dy zotërinjëve” (regjisor):</i>	
19	2016 – „Kokofest,, Festivali i Komedisë në Korçë. <i>Çmimi për shfaqjen më të mirë dhe regjinë më të mirë.</i>	4
20	nëntor 2015 – Manifestimi kulturor „Festat e nëntorit,, në Tetovë.	2
21	nëntor 2015 – „Skupifest,, Festivali Ndërkombëtar i Teatrit, Shkup.	4
22	tetor 2015 – Festivali i Teatrove në Ferizaj. <i>Çmimi për shfaqjen më të mirë dhe regjinë më të mirë.</i>	4
GJITHSEJ PIKË nga veprimtaria profesionale-aplikative:		84

IV. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Drejtor artistik i festivalit teatro "AKTFEST", Shkup, 2019.	1
2	Çmimi i publikut ("Audience Award") për filmin artistik me metrazh të gjatë "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" në "PRIFEST" Festivali Ndërkombëtar i Filmit në Prishtinë ("PRIFEST" Prishtina International Film Festival), 2019.	1
3	Çmimi „Special Mention, për filmin artistik me metrazh të gjatë "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Tiranë (Tirana International Film Festival), 2019.	1
4	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin e Teatrove në Ferizaj, për regjinë e shfaqjes teatrore "Një letër e humbur" 2019.	3
5	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin multimedial "Etnofest Kukaj" (Prishtinë), për regjinë e shfaqjes teatrore "Duet për një", 2019.	3
6	Anëtar i jurisë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit "Skupifest" - Shkup, 2018.	1
7	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit "Otello"- Gostivar, për regjinë e shfaqjes teatrore "Ata që ikin", 2018.	3
8	Çmimi për regjinë më të mirë të vitit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, për regjinë e shfaqjes teatrore "Ata që ikin", 2018.	3
9	Çmimi për shfaqjen më të mirë në Festivalin e Komedisë në Preshevë, për shfaqjen teatrore "Tartufi", 2017.	1
10	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin e Teatrove në Ferizaj, për regjinë e shfaqjes teatrore "Tartufi", 2017.	3
11	Çmimi për shfaqjen më të mirë në Festivalin e Komedisë "Kokofest" në Korçë, për shfaqjen teatrore "Shërbëtori i dy zotërinjve", 2016.	1
12	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin e Komedisë "Kokofest" në Korçë, për regjinë e shfaqjes teatrore "Shërbëtori i dy zotërinjve", 2016.	3
13	Çmimi për shfaqjen më të mirë të vitit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, për shfaqjen teatrore "Shërbëtori i dy zotërinjve", 2016.	1
14	Çmimi për shfaqjen më të mirë në Festivalin e Teatrove në Ferizaj, për shfaqjen teatrore "Shërbëtori i dy zotërinjve", nëntor 2015.	1

15	Çmimi për regjinë më të mirë në Festivalin e Teatrove në Ferizaj, për regjinë e shfaqjes teatrale “Shërbëtori i dy zotërinjve”, nëntor 2015.	3
GJITHSEJ PIKË nga veprimtari me interes më të gjërë:		29

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE (2015-2020)	Pikët
I. VEPRIMTARIA MËSIMORE – ARSIMORE	67.95
II. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – ARTISTIKE	96
III. VEPRIMTARIA PROFESIONALE – APLIKATIVE	84
IV. VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJËRË	29
GJITHSEJ PIKË:	276.95

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Fadil Hysaj, kryetar

2. Prof. dr. Metin Izeti, anëtar

3. Prof. dr. Nebi Islami, anëtar
